

1	Po.	Jo.	Nuk e di.	Nuk e kuptoj.
2	Si ju quajnë?	Mund ta shkruani emrin në anglisht?		
3	Ju lutemi shkruajeni adresën tuaj.			
4	Sa vjeç jeni?			
5	Mund të na jepni emrin dhe numrin e telefonit ose adresën e dikujt për t'ju kontaktuar?			
6	Ju do të ekzaminoheni së shpejti nga një	¹ doktor.	² infermiere.	
7	Keni patur një aksident?	Kur? (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë)		
8	E humbët ndërgjegjen?			
9	Kur u sëmurët? (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë)			
10	Keni dhembje?	Tregoni se ku.	Kur filloi? (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë)	
11	Cili është niveli i dhimbjes që keni?	1 (nuk keni dhimbje)	2	3 4 5 6 7 8 9 10 (dhimbje kronike)
12	Dhimbja është e vazhdueshme?	Apo vjen dhe ikën?		
13	A keni gjakrrjedhje?	Tregoni se ku.		
14	A keni pasur kollë?	A nxirrnit diçka pas kollës?		
	Çfarë ngjyre?	e bardhë?	e verdhë në të gjelbër?	e kuqe? kafe?
15	A ju merret fryma?			
16	Keni vjellë?	Keni vjellë gjak?		
17	Keni pasur diare?			
18	Jeni kaps?			
19	Keni bërë nevojë me ngjyrë të zezë?			
20	Ju janë fryrë gjunjët?			
21	Jeni dobësuar?			
22	Keni vështirësi	¹ shikimi?	² dëgjimi?	³ gëlltitjeje? ⁴ të ecni?
23	Keni kaluar ndonjë operacion?	Tregoni se ku.		
24	Kur ju filloi cikli i fundit menstrual? (tregoni në kalendar)	Jeni shtatzënë?	Sa muajshe jeni?	
	Ka mundësi të jeni shtatzënë?	Mund t'ju bëjmë një test barre?		
25	Pini cigare?	Sa cigare në ditë?		
26	Vuani nga	¹ diabeti i fëmijëve?	² epilepsia?	³ astma?
27	Keni pasur ndonjëherë	¹ probleme me zemrën?	² anginë?	³ tension të lartë të gjakut?
	⁴ infarkt?	⁵ aksident çerebral?	⁶ (verdhëz)ikter?	⁷ hepatitë?
28	Jeni alergjik nga ndonjë ilaç?	Penicilinë?	Aspirinë?	Ilaç tjetër?
29	Merrni ndonjë ilaç tani?	Keni ndonjë me vete?		
	A merrni mjekime të tjera ose mjekime natyrore?			
30	Sa tableta keni marrë?			
31	Jeni të mbuluar nga vaksina e tetanozit?			

- 32 Keni qenë në tjetër vend jashtë Mbretërisë së Bashkuar kohët e fundit? Ku? Kur?
- 33 Unë jam një: ¹infermiere. ²doktor. ³dhënës i ndihmës së shpejtë. ⁴paramjek. ⁵punonjës social.
- 34 Mund t'ju ekzaminoj? E keni problem të ekzaminoheni nga një 'burrrë? ²grua?
- 35 Më vjen keq, kjo mund t'ju dhembë.
- 36 Duhet t'ju mas tensionin e gjakut.
- 37 Duhet t'ju dëgjoj kraharorin.
- 38 Duhet t'ju testoj zemrën.
- 39 Duhet t'ju ekzaminoj për sëmundjet e brendshme.
- 40 Duhet t'ju bëj një injeksion.
- 41 Duhet t'ju fut këtë tub.
- 42 Duhet t'ju marr një analizë gjaku.
- 43 Duhet t'ju dërgoj për një radiografi.
- 44 Duhet t'ju vë disa penjë.
Duhet të shkoni tek mjeku juaj që t'ua heqë ato në këtë ditë (tregoni me gisht në kalendar dhe në orë).
- 45 Keni thyer/frakturuar: ¹këmbën. ²gjurin. ³krahun. ⁴kyçin e dorës. ⁵shpatullën.
- 46 Duhet t'ju vemë në allçi: ¹këmbën. ²gjurin. ³krahun. ⁴kyçin e dorës.
- 47 Duhet ta mbani këtë (tregoni) deri në këtë datë (tregoni në kalendar).
- 48 Ju lutemi hidhni ujë në këtë enë.
- 49 Mos hani as mos pini gjë.
- 50 Mund të ngriheni tani.
- 51 Duhet të rrini në spital.
Ju lutemi prisni derisa të lirohet një krevat në pavion.
- 52 Çdo gjë do të shkojë mirë. Mos u merakosni.
- 53 Mund të thërres një taksi për ju?
- 54 Përdorni këtë nëse keni nevojë për ndihmë.
- 55 Ju lutemi prisni. Ejani këtej. Mund të shkoni në shtëpi.
- 56 Ju lutemi kthehuni, nëse keni probleme përsëri.
- 57 Më lejoni t'ua përsëris...

Pyetje prej pacientëve

- 58 Sa do të pres? deri në 1 orë deri në 2 orë deri në 3 orë deri në 4 orë
- 59 A do ta thërresë njeri emrin tim?
- 60 Ku është telefoni, duhet të telefonoj familjen/një shok?
- 61 Mund të më thërrisni një taksi të shkoj në shtëpi?
- 62 A do të bëhem mirë?